

VENDIM
Nr.717, datë 16.7.2008

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO IDEA”
SUBJEKTIT: “CHANNEL 1” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 6.5.2008, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Channel 1” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Vlorës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)